

VENDIM
Nr. 79, datë 7.6.2016

**MBI MIRATIMIN E “KONTRATËS PËR SIGURIMIN E SHËRBIMEVE NDIHMËSE
DHE TË BALANCIMIT TË SISTEMIT ELEKTRO-ENERGJETIK, PËR
PERIUDHËN KOHORE 1.1.2016–30.6.2016” MIDIS OST SHA DHE KESH SHA**

Në mbështetje të neneve 16; 20, germa “h”, dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; kapitullit V, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Teknike në lidhje me “Kontratën për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektro-energjetik për periudhën kohore 1.1.2016–30.6.2016, midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.”,

konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate janë subjekte juridike të legjitimuara për nënshkrimin e kontratës “Për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektro-energjetik për periudhën kohore 1.1.2016–30.6.2016” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.”, duke pasur parasysh që licenca e shoqërisë OST sh.a., në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike është rinovuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 24, datë 26.3.2009 dhe licenca e shoqërisë KESH sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike është rinovuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 25.3.2009.

- Sipas parashikimeve të kapitullit V, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, marrëdhënia midis KESH sh.a. dhe OST sh.a. rezulton të jetë marrëdhënie e rregulluar.

- Duke qenë se “Kontrata për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit elektro-energjetik midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.” rregullon periudhën 1.1.2016–30.6.2016, vlen të sqarohet se baza ligjore në të cilën ajo gjen mbështetje për periudhën 1.1.2016–30.3.2016, janë nenet 51, gerrat “b” dhe “d”; 56, germa “f”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; parashikimet e Modelit të Tregut të Energjisë, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, i ndryshuar, dhe Rregullat e Tregut, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar.

Që nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, përcaktimet e Modelit të Tregut të Energjisë, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, i ndryshuar, nuk zbatohen më, duke vendosur kështu detyrimin për të miratuar këtë kontratë sipas VKM-së së sipërcituar.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, nuk ka fuqi prapavepruese dhe si e tillë nuk mund të rregullojë të gjithë periudhën e shkuar në të cilën ka shtrirë efektet kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit. Efektet fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të kësaj VKM-je.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kontratën “Për sigurimin e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit të sistemit

elektro-energjetik midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.”, për periudhën kohore 1.1.2016–30.6.2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti